



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA / OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

Raporti Vjetor i Performancës

2009

PËRMBAJTJA

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm

1.	PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS	1
2.	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.....	4
3.	TREGUESIT E REZULTATIT.....	6
4.	BURIMET.....	10
5.	DUKJA NGA JASHTË E ORGANIZATËS TONË	15
6.	TË ARRITURAT STRATEGJIKE.....	17
7.	LLOGARIDHËNIA E ZAP-SË	19

SHTOJCA: PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË ZAP-SË PËR VITIN 2009

FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

I nderuar z. Kryetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës



Dëshiroj të filloj duke ju falënderuar për të gjithë mbështetjen që i keni dhënë institucionit tim gjatë vitit të kaluar.

Përpara jush keni Raportin e dytë Vjetor të Performancës nga Auditori i Përgjithshëm. Ky raport përqendrohet në mënyrën se si Auditori i Përgjithshëm i ka shfrytëzuar burimet dhe në rezultatet e arritura gjatë vitit 2009. Gjithashtu, ky raport mundëson krahasimin me dy vitet paraprake fiskale.

Raporti Vjetor i Performancës është një përgjigje e rëndësishme drejtuar Kuvendit të Kosovës tek i cili Auditori i Përgjithshëm raporton rreth ushtrimit të mandatit për vitin 2009. Në të njëjtën kohë, raporti shërben si një kontribut në dialogun për buxhetin mes Kuvendit dhe Auditorit të Përgjithshëm për vitin buxhetor 2010.

Raporti mbulon një vit të rëndësishëm për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Viti 2009 ishte një vit kur u vendos një platformë e re për të pasur një zyrë të ristrukturuar dhe u paraqit një qasje e re për

funksionimin dhe menaxhimin. Hapat e para u morën në krijimin e një platforme në pajtim me marrëveshjen mes Kosovës dhe BE-së. Me themelimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike janë qartësuar dhe forcuar gjithashtu linjat e llogaridhënies mes Kuvendit dhe Zyrës.

Këto ndryshime të mëdha të parakushteve, krijojnë për zyrën sfida për sa i përket trajtimit si të çështjeve operative ashtu edhe atyre administrative dhe financiare. Por, gjithashtu krijojnë edhe kushte e mundësi të reja për zyrën dhe hisedarët e saj, autoritetin Legjislativ dhe atë Ekzekutiv. Këto marrëdhënie pune do të zhvillohen edhe më tej për të krijuar një kornizë të përbashkët referimi për të gjithë ne.

Vizioni dhe strategjia jonë janë që të bëhemi një institucion publik i auditimit të jashtëm plotësisht në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikën e mirë Evropiane. Ky raport pasqyron se ne kemi bërë hapa të rëndësishëm në këtë rrugëtim pa fund. Në të njëjtën kohë, ne jemi plotësisht të vetëdijshëm mbi varësinë tonë në bashkëpunimin dobiprurës dhe në një dialog të mirë për buxhetin me hisedarët kryesorë për të përmbushur ambiciet tona të larta dhe qëllimin tonë të përbashkët - një sektor publik më të mirë dhe më të përgjegjshëm në Kosovë.

Unë shpresoj se ky raport mund të kontribuojë në përforcimin e këtij vizioni.

Prishtinë, 30 prill 2010

Lars Lage Olofsson
Auditor i Përgjithshëm

Misioni i ZAP-së është që:

“të kontribuojmë për një menaxhim të shëndoshë financiar në administratën publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në pajtim me standardet e auditimit të njohura ndërkombëtarisht si dhe me praktikën e mirë Evropiane. Ne do të krijojmë mirëbesimin në shpenzimin e fondeve publike. Do të luajmë një rol aktiv për të siguruar interesin e taksapaguesve dhe hisedarëve të tjerë në rritjen e llogaridhënies publike”.



1. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS

Viti i auditimit 2009 ishte një vit i mirë për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) nga të gjitha pikëpamjet materiale. Ne krijuam platformën e parë themelore në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (INTOSAI) dhe praktikën e mirë evropiane. Ne dhamë atë çka duhej të jepnim, në kohën e duhur për herë të parë, me një mbulim të mirë të detyrimit (mandatit) për auditim, kemi siguruar cilësi në përputhje me qasjet moderne për cilësinë e auditimit, kemi thjeshtësuar raportimin tonë tek hisedarët në pajtim me standardet ndërkombëtare (SNISA 400), kemi zhvilluar një dialog dobiprurës dhe vazhdimin e tij me hisedarët tanë kryesorë: Kuvendin, Qeverinë, sidomos Ministrinë e ekonomisë dhe financave (MEF), dhe të gjithë entitetet tona të audituara. Staf i ynë e ka mbështetur këtë qasje në një mënyrë entuziaste dhe të zotuar, e cila është një shenjë e mirë për vitet që do të pasojnë.

Pikat kryesore

Sezoni i auditimit 2008/09 përfundoi në shtator. Duke bërë një përmbledhje të këtij sezoni:

- Ne raportuam për 23 auditime të rregullsisë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK) dhe një auditim të rregullsisë jashtë BKK-së;
- Ne raportuam dy auditimet e para të performancës ku janë ofruar analizat dhe rekomandimet mbi efikasitetin dhe efektivitetin në programet dhe organizatat publike; si dhe shërbime më të mira për qytetarët;
- Raporti ynë gjithëpërfshirës Vjetor i Auditimit (RVA) u shpërnda në kohën e duhur për herë të parë, dhe në të gjitha pikëpamjet ai ishte relevant, konsistent, dhe i qartë;
- Për herë të parë, Raporti vjetor i performancës (RVP) u shpërnda në kohën e duhur si bazë për të konsideruar Auditorin e Përgjithshëm përgjegjës për rezultatet e arritura dhe mënyrën se si është zbatuar buxheti;
- Auditimet tona u fokusuan kryesisht mbi pajtueshmërinë dhe janë siguruar për nga ana e cilësisë në pajtim me standardet e aplikueshme të auditimit të INTOSAI-t;
- Auditimi ynë i rregullsisë përfshiu organizatat me 80% të shpenzimeve të përgjithshme dhe 95% të të hyrave të përgjithshme të BKK-së; dhe
- Një platformë e re themelore u miratua për organizatën ku adresohen udhëheqja strategjike, standardet e auditimit, etika, dhe një organizim i ri.

Sezoni i auditimit 2009/10 filloi në shtator, dhe gjatë vitit 2009 ne:

- Themeluam një projekt të ri binjakëzimi me kolegët tanë nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Britanisë së Madhe, të cilët së bashku me kolegët nga Holanda dhe Sllovenia na këshillojnë dhe na përgatisin për zbatimin e pjesëve të rëndësishme të Strategjisë tonë të Përbashkët për Zhvillim (udhëzuesi ynë në rrugën e zhvillimit për vitet pasuese).
- Filluam auditimet e mbetura të rregullsisë për Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) të 32 komunave për vitin 2008, përveç komunës së Prishtinës. 31 prej tyre janë kontraktuar tek firmat private të auditimit dhe të gjitha janë raportuar në dhjetor, dhe i fundit u raportua në janar të këtij viti;
- Filluam 34 auditime të reja të rregullsisë në BKK dhe auditimin në Buxhetin qendror të Konsoliduar të Kosovës. Përveç kësaj, filluam 6 auditime të rregullsisë jashtë BKK-së dhe auditime të performancës: 43 auditime kryhen nga ne. I kemi kontraktuar jashtë 29 auditime të PVF të komunave për vitin 2009. Ato do të publikohen në qershor 2010. Në tërësi, ne jemi organizuar për një sezon ku Raporti jonë Vjetor i Auditimit do të bazohet mbi 72 auditime në vend të 26 sa u raportuan në sezonin e kaluar të auditimit;

-
- Qasja në auditimin e rregullsisë përfshin *auditimin e parakohshëm* gjatë vitit buxhetor. Synimi është që të krijohet një dialog më i mirë me entitetet e audituara për të siguruar veprimet në gjetjet e auditimit, adresimin e hershëm të problemeve dhe sfidave, si dhe për të zvogëluar gabimet në raportet tona të jashtme. Kjo qasje më shumë parandaluese dhe konsultative ka hapur një rrugë tërthore kur bëhet fjalë për ndikim. Memorandumet janë hartuar dhe i janë dërguar të gjitha entiteteve të audituara;
 - Ndërmorëm një sërë masash për të përballuar sfidat pas aprovimit të kornizës tonë ligjore;
 - Qasja parandaluese shoqërohet me fillimin e një bashkëpunimi të ngushtë me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe me strukturat brenda Qeverisë të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin, dhe mbikëqyrjen e qeverisjes së mirë, veçanërisht Menaxhimin dhe kontrollin e financave publike dhe Auditimin e brendshëm;
 - Ne i bëmë të gjitha këto në të njëjtën kohë kur, duke pasur parasysh mandatin dhe pritshmëritë tona, e realizuam buxhetin tonë mirë dhe brenda kufijve të caktuar; dhe
 - Raporti i fundit i *Transparency International* për vitin (2009) i vlerësoi ZAP-në (së bashku me Ombudspersonin) si organizata me performancën më të mirë dhe më e besueshme në sektorin publik.

Fushat për përmirësim

Synimet e veçanta të auditimit janë shfrytëzimi i drejtë dhe efektiv i fondeve publike; zhvillimi i një menaxhimi të shëndoshë financiar; ekzekutimi i drejtë i veprimeve administrative; dhe kumtimi i informatave autoriteteve publike dhe publikut të gjerë nëpërmjet publikimit të raporteve objektive. Zbatimi i kësaj konsiderohet si i domosdoshëm për stabilitetin dhe zhvillimin e shteteve në përputhje me objektivat e INTOSAI-it (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit).

Ne jemi të dedikuar për tu bërë një Institucion Suprem i Auditimit (ISA) me performancë të mirë. Disa veçori të rëndësishme të kësaj janë si në vijim:

- Përbushja e rolit tonë si një *shtyllë* e rëndësishme e sistemit të *llogaridhënies* në demokracinë moderne - një ndërgjegjësim i lartë konceptual i rolit dhe detyrave tona. Roli i një *verifikuesi të pavarur të informatave ekonomike dhe të performancës si dhe statusi nga këndvështrimi i ligjshmërisë dhe 3 E-ve (ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit)* në zinxhirin komandues: Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) - Ministria - Qeveria dhe Kuvendi;
- *Raporte të mira pune* me Kuvendin dhe Qeverinë, Median dhe Publikun;
- *Të vepruarit në baraspeshë me aktorët e tjerë* në Sistemin e Menaxhimit të Financave Publike: duke optimizuar përfitimet në tërë sistemin e Menaxhimit të Financave Publike;
- Promovimi i standardeve të larta të transparencës, përgjegjshmërisë dhe integritetit në menaxhimin financiar dhe performancën e administratës publike;
- Përbushja e plotë e *mandatit dhe fushëveprimit tonë të auditimit në mënyrë të baraspeshuar, qëndrueshme dhe afatgjate*;
- Duke ju përmbytur *standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht*;
- Të perceptuarit nga aksionarët tanë si një *burim i informatave i pavarur, objektiv dhe besueshëm*;

-
- *Dorëzimi i raporteve të auditimit të cilësisë së lartë në kohën e duhur - duke ua shtuar vlerën hisedarëve tanë;*
 - *Të pasurit e procedurave pasuese të zhvilluara mirë për ndërmarrjen e veprimeve në gjetjet dhe rekomandimet e auditimit nga palët e interesuara – entitetet e audituara, Qeveria dhe Kuvendi;*
 - *Shfrytëzimin e qasjes moderne të Menaxhimit të Cilësisë së Plotë për Menaxhimin Cilësor të Auditimit; dhe*
 - *Dukja nga jashtë e organizatës tonë - duke kërkuar në vazhdimësi për përmirësime dhe për përdorimin më efikas të burimeve.*

Transformimi i ZAP-së në një ISA me Performancë të mirë do të marrë kohë. Megjithatë, rezultatet e arritura deri më sot (prill 2010) janë inkurajuese. Platforma e parë themelore për një zhvillim të mëtejshëm është themeluar tashmë me sukses. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për shkathhtësitë teknike. Kjo ka të bëjë edhe me të kuptuarit e rolit të një ISA në një shoqëri demokratike dhe me zbatimin e strategjisë tonë afatgjate. Për më tepër, këtu kemi të bëjmë me mënyrën e sjelljes me kulturorë e në përputhje me vlerat tona: llogaridhënia, transparenca, sinqeriteti, reagimi dhe zhvillimi i ndryshimeve që duhet zbatuar në praktikë.

Ashtu siç e përmendëm më lart, një hap të mençur për të zbatuar një sërë platformash mjaft të fuqishme dhe të zhvilluara gjatë viteve në vijim. Gjatë vitit 2010, ne do të fokusohemi veçanërisht mbi:

- Përfundimin e sezonit të auditimit me cilësi të lartë, në pajtim me standardet ndërkombëtare, dhe në kohën e duhur;
- Fillimin e sezonin të ardhshëm të auditimit bazuar mbi një Strategji të Auditimit të zhvilluar dhe operative, duke përfshirë një fokusim më të madh mbi fushat që janë duke pësuar një ndryshim rrënjësor;
- Adresimin e kornizës tonë ligjore me qëllim që amendamentet e propozuara të futen në rendin e ditës së Kuvendit në fillim të vitit 2011;
- Sigurimin e ambienteve të reja të mjaftueshme për zyrën tonë, të cilat do të na mundësojnë të kryejmë auditim të cilësisë së lartë në përputhje me ambicien tonë dhe në pajtim me kornizën tonë strategjike;
- Krijimi i mundësive të mira për zhvillim profesional me një fokus të veçantë mbi të zyrtarët tanë të trajnuar;
- Sigurimin e vendimeve të Kuvendit në kohën e duhur për auditimin e PVF-ve tona; nxjerrjen e përfundimeve nga ky sezon auditimi dhe masat për zhvillim që rregullojnë sezonin tonë tjetër në përputhje me rrethanat; dhe
- Sigurimin e partnerëve për bashkëpunim në të ardhmen. Projekti i binjakëzimit përfundon në verë 2011 dhe partnerët e rinj duhet të gjinden më herët me qëllim të kuptueshmërisë më të mirë të kontekstit tonë vendor. Pas gjysmës së vitit 2011 ne nuk presim më ndihmë nga BE-ja.

2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Kush jemi ne

Unë jam emëruar në postin e Auditorit të Përgjithshëm në fillim të vitit 2009 nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) pas Zgjidhjes Gjithëpërfshirëse të Statusit nga ana e Qeverisë së Kosovës, dhe unë e kam marrë detyrën më 1 Mars. Nga unë kërkohet që të jem i pavarur nga Qeveria dhe ti raportojë drejtpërdrejt Kuvendit. Roli im është që të ndërtojë kapacitetet organizative dhe të hapë rrugën për një Institucion Suprem të Auditimit të qëndrueshëm nën pronësi të Kosovës. Deri në dhjetor stafi im përbëhej nga 85 anëtarë, në prill të këtij viti ne jemi 116 të punësuar si staf i auditimit dhe staf mbështetës.

Mandati dhe detyrat e mia janë të përcaktuara me Kushtetutën dhe me Ligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë.

Ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë tonë nga organizatat të cilat i auditojmë është vendimtare. Objektivat tona për pavarësi duhet të sigurohet me zbatimin e mirë të një mandati të gjerë dhe të qëndrueshëm ligjor; pajtueshmërinë me standardet profesionale të auditimit; kodin e brendshëm të fortë të mirësjelljes profesionale; si dhe me një mandat 5-vjeçar për Auditorin e Përgjithshëm.

Çfarë duhet të bëjmë?

Ne do të kryejmë Auditimet e Rregullsisë të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, organizatave buxhetore në bazë vjetore, duke përfshirë këtu edhe Kuvendin, Zyrën e Presidentit, çdo Ministri dhe Agjenci ekzekutive, Komunitat, organet e pavarura dhe entitete të tjera.

Ne gjithashtu kemi fuqinë – për aq sa kemi liri veprimi, pra nuk është e detyrueshme - për të kryer *Auditimin e Performancës* aty ku mund të ekzaminojmë, ndaj kriterëve të vendosura, nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar me kujdesin e duhur, ekonomikisht dhe mënyrë efikase, dhe nëse janë të vendosura masat për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

Ne do të raportojmë për auditimet tona tek entitetet e audituara dhe Kuvendi (Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike) dhe këto raporte do të publikohen. Raportet tona do të përmbajnë rekomandime për të adresuar mangësitë më serioze të identifikuara.

Ne do të ndihmojmë në zbatimin, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Menaxhimit të Financave Publike, që karakterizohet me transparencë dhe përgjegjshmëri. Ne do ta bëjmë këtë duke siguruar se fondet publike raportohen, administrohen, dhe përdoren në mënyrën e duhur dhe me mençuri. Synimet tona janë që tu ofrojmë siguri tatimpaguesve dhe donatorëve ndërkombëtarë se burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase dhe ti shtojmë vlerë proceseve përkatëse zhvillimore.

Si do ta dëshmojmë përgjegjshmërinë?

Kush e auditon Auditorin e Përgjithshëm?

Çdo vit, Kuvendi duhet të emërojë një auditor të jashtëm për të bërë auditimin e Pasqyrave tona Vjetore Financiare (PVF). Pasqyrat tona financiare do të përgatiten sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë si dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik mbi Bazat e Parasë së Gatshme.

Pasqyrat financiare për Vitin Fiskal 2009 janë të përfshira në këtë Raport Vjetor të Performancës (RVP). Auditimi i këtyre pasqyrave financiare nuk ka përfunduar ende. Në RVP-në e vitit që kaloi, unë propozova që Kuvendi të emërojë një auditim për të dy vitet fiskale 2008 dhe 2009 para Shtatorit të vitit 2009 me synim që të mundësohet përpilimi i një RVP-je për vitin 2009 i bazuar në pasqyra të audituara financiare. Kjo nuk është materializuar ende, por unë e parashikoj që do të ndodhë brenda një të ardhme të afërt. Kjo situatë ka gjasa që të çojë në

marrjen e pikëve më pak sesa do të na nevojiteshin për vlerësimin e ardhshëm të BE-së dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë.

Sipas Ligjit Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ne duhet të kemi në funksion një auditor të brendshëm për të audituar praktikat tona menaxhuese dhe ato të administrimit për të më siguruar mua se zyra është në pajtueshmëri me ligjet dhe politikat e vetë zyrës. Ky auditim i brendshëm do ti ofronte menaxherëve, vlerësime dhe rekomandime. Në mars të vitit 2010 ne emëruam një auditor të brendshëm.

Kush do ti vlerësojë metodologjitë tona të auditimit?

Puna jonë e auditimit do të udhëhiqet nga një metodologji e mirë dhe nga kornizat e menaxhimit të cilësisë. Këto korniza duhet të ofrojnë siguri të mjaftueshme që auditimet tona kryhen në pajtim me standardet e themeluara të praktikës profesionale.

Ne tashmë jemi në proces të zbatimit të këtyre kornizave dhe e kemi ri-organizuar zyrën duke krijuar funksione të cilat sigurojnë që kornizat janë dizajnuar në mënyrë të përshtatshme dhe se funksionojnë në mënyrë të efektive.

Auditimi modern është dizajnuar me një strukturë *kontrollesh dhe bilancesh* për të siguruar në radhë të parë cilësi dhe metoda të mira, d.m.th përpara se të merret vendimi zyrtar mbi raportin e auditimit, p.sh të aplikohen standardet rigoroze të auditimit; trajnimi i stafit; procedurat kontradiktore me entitetet e audituara; vendimi final i një niveli të lartë pas sigurimit të cilësisë së auditimit të brendshëm; dhe pastaj pas publikimit të raporteve tona, ato janë publike dhe të hapura për shqyrtim dhe për kritika për shumë vite; debatet në Kuvend dhe diskutimet me Ekzekutivin mbi rekomandimet e auditimit. Ky dizajn është parimisht i njëjtë në të gjitha vendet që kanë një ISA të zhvilluar mirë. Kjo është një siguri e madhe për të pasur cilësi me kalimin e kohës.

Parë nga një perspektivë më e gjatë, ne do të krijojmë rishikime të jashtme periodike nga kolegët, siç janë ISA-të e tjera.

Kush do të rishikoj financimin tonë?

Si Auditor i Përgjithshëm, unë duhet që – përveç këtij RVP-je që fokusohet mbi mënyrën si është shpenzuar buxheti i Zyrës – të përgatis kërkesat për buxhet në baza vjetore dhe t'ia dorëzojë ato Kuvendit. Komisioni për Buxhet dhe Financa mund të më ftojë për ti shpjeguar kërkesën për buxhetin e zyrës dhe do të diskutojmë raportin tonë lidhur me planet dhe prioritet, synimet e performancës, Raportin tonë Vjetor të Performancës, dhe praktikat tona të menaxhimit.

Qeveria do të inkorporojë kërkesën time për buxhet në draft BKK, i cili i dorëzohet Kuvendit, ashtu siç propozohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Buxheti i zyrës do të miratohet nga Kuvendi. Në praktikë, proceset aktuale lejojnë hapësirë për përmirësime.

3. TREGUESIT E REZULTATIT

Treguesit e rezultatit që ne po i përdorim janë:

1. Numri i raporteve të përpiluara;
2. Mbulimi i auditimit;
3. Opinionet e dhëna;
4. Afatet kohore të raporteve tona;
5. Cilësia; dhe
6. Ndikimi.

1. *Numri i raporteve të përpiluara;*

Sezoni i auditimit për 2008/2009 ka mbaruar në Shtator 2009. Në përfundim të sezonit, ne:

- Raportuam për 23 Auditime të Rregullsisë brenda BKK-së dhe një Auditim të Rregullsisë jashtë BKK-së;
- Raportuam për dy Auditime të para të Performancës; Shpërndarjen e Barnave Esenciale nga Departamenti Farmaceutik dhe Skema Pensionale për Persona me Aftësi të kufizuara; dhe
- Filluam me auditimet e mbetura të PVF-ve të 32 Komunave për vitin 2008, përveç Komunës së Prishtinës. 31 nga këto Raporte janë kontraktuar nga kompani private të auditimit dhe për të gjitha këto është raportuar në muajin Dhjetor të vitit të kaluar dhe Janar të këtij viti.

Në tërësi, ne kemi kryer 58 Auditime të Detyrueshme të Rregullsisë (përfshirë këtu edhe Raportin e BKK-së).

Tabela 1, tregon një nivel mjaft të qëndrueshëm të auditimeve të kryer për këto tri vite të fundit. Numri i auditimeve të kontraktuara është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Arsye për këtë kryesisht është nevoja për të mbuluar të gjitha Komunitet me auditim të detyrueshëm të Rregullsisë edhe pse, nga këndvështrimi i BKK-së, nuk është posaçërisht materiale. Në procesin e vazhdueshëm të decentralizimit të përgjegjësive të menaxhimit financiar, auditimit të jashtëm i është dhënë një rol kryesor si pikë referimi për decentralizimin e vazhdueshëm.

Tabela 1 Raportet e publikuara të auditimit¹

Entitetet e audituara	2009			2008			2007		
	Auditimet e detyrueshme	Auditimet e raportuara		Auditimet e detyrueshme	Auditimet e raportuara		Auditimet e detyrueshme	Auditimet e raportuara	
		ZAP	Kontraktues të jashtëm		ZAP	Kontraktues të jashtëm		ZAP	Kontraktues të jashtëm
BKK	1	1		1	1		1	1	
Autoritetet Shtetërore	17	17		23	16		19	17	
Komunitet	33	2	31	33	10	19	31	27	
Të tjera	69	5		52	8		51	8	1
Jashtë BKK-së		1							
Totali	120²	26	31	109	35	19	102	53	1

Tabela 2 tregon auditimet që janë kryer nga ana e Kontraktuesve të jashtëm duke treguar edhe koston e këtyre auditimeve.

¹ Shënime të paraqitura për vitin 2009 mbulojnë auditimin e vitit fiskal 2008, e kështu me radhë.

² Auditimet e detyrueshme vjetore mund të dallojnë nga viti në vit varësisht nga mënyra se si strukturohet buxheti.

Tabela 2 Auditimet e kryera nga ana e Kontraktuesve të Jashtëm

Entitetet e audituara	2009			2008			2007		
	Firma Private e kontraktuar nga ZAP	Nr. i Auditimeve	Kosto e auditimeve €	Firma Private e kontraktuar nga ZAP	Nr. i Auditimeve	Kosto e auditimeve €	Firma Private e kontraktuar nga ZAP	Nr. i Auditimeve	Kosto e auditimeve €
Komunat	1. Deloitte 2. KPMG	12 19	64,640 84,300	Deloitte	19	54,800			
Fondi i privatizimit							G. Thornton	1	39,675
ZAP				G. Thornton	1	6,000			
Total:		31	148,940		20	60,800		1	39,675

2. Mbulimi i auditimit

Auditimi ynë i rregullsisë tek autoritetet e organizatave të adresuara nën BKK mbulojnë 80% të shpenzimeve të përgjithshme dhe 95% të të hyrave të përgjithshme.

Krahasuar me vitin e mëhershëm, Tabela 3 tregon, si në vijim:

Tabela 3 Mbulimi i Auditimit të BKK-së (%)

Mbulimi	2009	2008	2007
Shpenzimet	80	71	67
Të hyrat	95	86	89

Tabela tregon uljet në auditimin e implementimit të vitit 2007 i cili është kryer gjatë vitit 2008. Situata e paqartë e menaxhimit, përdorimi i kufizuar i fondeve në dispozicion për kontraktim të auditimeve dhe greva e auditorëve gjatë verës së vitit 2008 mund të kuptohen si shpjegime.

3. Opinione e dhëna

Opinionet e dhëna në Raportet e Auditimet e Rregullsisë gjatë vitit 2009 për vitin 2008 janë të ndryshme në krahasim me atë që është bërë viteve paraprake. Për shkak të ndryshimeve në qasjen e auditimit, sipas pikëpamjes time nuk është e kuptimtë të krahasohen ato dhe të tentohet të nxirren konkluzione në lidhje me faktin nëse cilësia e informacionit brenda tyre, apo menaxhimi financiar i entitetit të audituar, është përmirësuar apo jo. Për një krahasim të tillë nevojitet një analizë më e thelluar.

Auditimi tashmë bazohet në standarde të aplikueshme, të njohura si SNISA-të³. Rezultati është si në vijim:

- Katër Opinione ishin të pakualifikuara. Në këtë grup përfshihet edhe Raporti i BKK-së;
- Shtatëmbëdhjetë Opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes;
- Katër Opinione ishin të kualifikuar;
- Për 31 Komuna, Auditorët nuk kanë mund të nxjerrin një konkluzion për shkak të mungesës së prezantimit të paqartësive në lidhje me pjesët materiale të pasqyrave financiare; dhe

³ SNISA-të janë standardet ndërkombëtare të auditimit për Institucionet Supreme të Auditimit.

-
- Një Komunë ka refuzuar të prodhoj PVF dhe si pasojë ne nuk kemi mundur të kryejmë auditimin e asaj Komune.

Kemi dhënë një *opinion të pakualifikuar* kur në të gjitha aspektet materiale ne kemi qenë të kënaqur që:

- Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza dhe politika të pranueshme të kontabilitetit të cilat janë aplikuar në mënyrë konsistente;
- Pasqyrat janë në pajtim me kërkesat ligjore dhe rregulloret përkatëse;
- Pikëpamja e prezantuar nga pasqyrat financiare është konsistente me njohuritë e Auditorit të entitetit të audituar; dhe
- Ekziston një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale për sa i përket pasqyrave financiare.

Një *Opinion i kualifikuar* paraqet probleme serioze në raportim financiar dhe menaxhim financiar të buxhetit publik.

4. Afatet kohore të raporteve tona

Afatet kohore të raportimeve tona kanë qenë më të mira se më herët. Detyrat individuale të auditimit të shpenzuesve buxhetor do të raportohen para fundit të qershorit për vitin pas vitit buxhetor. Auditimet e Rregullsisë që ne i kemi kryer ishin mesatarisht me tri javë vonë si dhe u raportuan gjatë korrikut, auditimi i komunave shumë më vonë, siç u tha më lartë. Objektivat për sezonin aktual është që çdo gjë të finalizohet me kohë.

Raporti ynë gjithëpërfshirës vjetor i auditimit për vitin 2008 është prodhuar me kohë për herë të parë dhe i është dorëzuar Kuvendit në fund të gushtit: dhe në të gjitha pikëpamjet raporti ka qenë relevant, konsistent, dhe i qartë.

5. Cilësia

Auditimet tona të vitit 2009 të implementimit të buxhetit kryesisht ishin të fokusuar në pajtueshmërinë dhe cilësia ishte e standardit bazik.

Korniza e cilësisë është aplikuar në fund të sezonit të auditimit duke siguruar një cilësi më të mirë në krahasim me raportet e mëparshme për sa i përket konsistencës dhe qartësisë.

Korniza e cilësisë është pjesë përbërëse e qasjes së auditimit pothuajse që nga fillimi i sezonit të auditimit 2009/10. Adresimi i çështjeve të cilësisë qysh herët në procese gjithmonë do të siguroj cilësi më të mirë.

6. Ndikimi

Entitetet e audituara më herët kanë zbatuar rekomandimet e dhëna në një përqindje pak sa të vogël. Arsyeja për këtë mund të gjendet në mënyrën se si janë dhënë dhe formuluar këto rekomandime si dhe në perceptimin e rezultatit të auditimit jo plotësisht në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht.

Në të njëjtën kohë, mund të theksohet që dëshira apo mundësia për të marrë në konsideratë këshillat tona janë në një nivel jo të mjaftueshëm.

Mënyra se si janë dhënë rekomandimet gjatë vitit 2009, dhe ndryshimi i qasjes së auditimit, tregojnë për llogaridhënien e menaxherëve për të adresuar mangësitë në një mënyrë më të

drejtpërdrejtë. Këto masa kanë çuar drejt një marrëdhënie më të zhvilluar mes nesh dhe entiteteve të audituara. Tendenca e qartë është se planet e veprimit të entiteteve të audituara

janë duke u bërë më rigorozë dhe rekomandimet janë duke u adresuar në mënyrë më të matur. Tashmë varet nga të dy palët të ndihmojnë në rezultate më të mira në kuptimin e ndryshimeve të qëndrueshme.

Kur kemi të bëjmë me keq menaxhim, ne kemi diskutuar me Qeverinë për rëndësinë që njerëzit të mbahen përgjegjës. Mbetet të shihet çfarë ndikimi kemi pasur mbi këtë çështje.

Një aspekt tjetër i kësaj është edhe interesi i kufizuar i Kuvendit që të ndër marrë veprime për cilindo raport i cili nuk i është përshtatur kornizës kohore të procesit të buxhetit dhe në të njëjtën kohë. Rëndësia e këtij niveli të zinxhirit të përgjegjësisë mund të diskutohet. Do të ishte e dobishme për Kuvendin që të mbajë seanca dëgjimore me stafin menaxhues të entiteteve të audituara që kanë opinione jo të favorshme.

Një sfidë e madhe për ne është përmirësimi i proceseve tona, në mënyrë që të finalizojmë auditimet tona me kohë, me cilësi të mjaftueshme, dhe në numër sa më të madh. Vendosija e një kalendari të ri për kryerjen e auditimit të sezonit në fjalë ka sjellë vonesa. Shumica e raporteve të Komunave që mbulojnë vitin 2008 janë publikuar kah fundi i vitit 2009 apo në fillim të këtij viti. Megjithatë që nga themelimi i ZAP-së, për herë të parë në vitin 2009 ne ishim në gjendje të paraqesim raportin e BKK-së në kuadër të kornizës kohore siç parashihet me ligj. Ndryshim substancial është vërejtur edhe tek cilësia e raporteve (lexueshmëria, qartësia, kuptueshmëria, pajtueshmëria me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit).

Mos respektimi i afateve kohore dhe ndër lidhja e limituar në procesin e llogaridhënies zvogëlon vlerën e auditimeve të kryera. Kjo shpesh herë ka të bëjë me problemet e lexueshmërisë së raporteve tona. Ka vend për përforsim të raportimit më të mirë financiar dhe menaxhimit financiar.

Aktualisht jemi duke ndër marrë hapa për ta ndërruar këtë situatë dhe qasjet tona në raportim të auditimit të PVF-ve 2009. ZAP tashmë ka vendosur afatet e kërkuara, por të arritshme, kohore për raportim në pajtim me kërkesat ligjore gjatë këtij viti.

Po ashtu është më rëndësi të përmendet që ne kemi ndër marrë hapat e nevojshme në mënyrë që të rrisim performancën e auditimit nga viti në vit. Kjo do të jetë pjesë e rëndësishme e portofolios sonë në vitet që do të vijjnë.



Trajnimi në Sharr

4. BURIMET

Burimet tona kanë prejardhjen nga burimet e ndryshme: Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK), Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN), dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE). Këto kontribute paraqiten në mënyrë më të detajuar më poshtë.

4.1 Fondet

BKK

Buxheti fillestar për vitin 2009 ishte 1,106,963 €. Ky ishte më i ulët në krahasim me vitin 2008 dhe është ndjekur me zbatim të ulët të buxhetit po atë vit. Në vitin 2008 ne nuk kemi mbuluar mandatin tonë në mënyrë të kënaqshme e në të njëjtën kohë ne kemi pasur burime prej 260,000€ të përcaktuara për auditimet e jashtme, ndërsa ne kemi shpenzuar vetëm 61,000 € (shih tabelën 2). Si pasojë i këtij rezultat buxhetor, kjo linjë buxhetore është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme për vitin fiskal 2009.

Në rishikimin gjashtëmuor, ne kemi kërkuar fonde për 16 anëtarë shtesë të stafit në pajtim me marrëveshjen në mes Kosovës dhe BE-së. Kjo nuk është materializuar para fundit të muajit nëntor. Si shkak i kësaj, realizimi i buxhetit për Paga dhe Mëditje nuk është i mirë aq sa do të duhej të ishte.

Zbatimi i buxhetit të përgjithshëm për vitin 2009 ishte 89%.


Tabela 4 BKK (në euro 000)

Raporti Buxhetit	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Shpenzuar	%
2007				
Buxheti Përgjithshëm	1,243	1,227	853	69.5%
Paga dhe Mëditje	358	347	336	96.7%
Mallra dhe Shërbime	817	812	463	57.0%
Shërbime Komunale	28	28	23	80.7%
Investime Kapitale	40	40	32	79.7%
2008				
Buxheti Përgjithshëm	1,204	1,204	863	71.6%
Paga dhe Mëditje	360	523	406	77.5%
Mallra dhe Shërbime	812	649	429	66.2%
Shërbime Komunale	33	33	28	85.0%
2009				
Buxheti Përgjithshëm	1,107	1,290	1,146	88.9%
Paga dhe Mëditje	523	666 ⁴	585	87.9%
Mallra dhe Shërbime	551	591	535	90.5%
Shërbime Komunale	33	33	26	79.5%

⁴ Fondet buxhetore shtesë prej 33,400 për auditorët janë shtyrë nga Qershori deri në fund të muajit Nëntor

Gjatë vitit 2009 burimet tona janë përdorur në fushat kryesore në vijim:

Diagrami 1 Fushat e burimit në përqindje



Burimet tjera buxhetore

ZCN-ja ka financuar dy anëtarë të stafit nga marsi i vitit 2009. Në pjesën e fundit të vitit 2008 ZCN-ja ka financuar 5 anëtarë të stafit si staf të përkohshëm pas mbylljes së shtyllës së IV të UNMIK-ut. Trendi, kur bëhet fjalë për financimin e stafit, është në rënie e sipër në mënyrë domethënëse gjatë tre viteve të fundit:

- 2009: 2 (AP dhe Udhëheqësi i Sekretariatit të tij);
- 2008: 5 (AP, Zëvendës AP dhe Këshilltarët); dhe
- 2007: 8 (AP, Zëvendës AP dhe Këshilltarët).

Veç kësaj, ZNKE ka financuar projektin e binjakëzimit “Mbështetja për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës gjatë vitit 2009”. Ky projekt do të zgjasë për dy vite dhe do të përfundojë në fund të korrikut 2011. Ky është një projekt që ka për qëllim forcimin e auditimit dhe kapacitetet e ndërlihdura të Auditorit Shtetëror të Kosovës. Ky projekt është vazhdim i mbështetjes së mëhershme.

Tabela 5 Staf i ZAP-së financuar nga ZCN/Shtylla IV e UNMIK-ut.

KATEGORIA	2009	2008	2007
Mbështetje Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (Projekti i Binjakëzimit)	157,315		
Mbështetje për Krijimin dhe Themelimin e ISA-së në Kosovë		-	-
Mbështetja për Auditimet e ZAP-së		-	400,000
Mbështetja e vazhdueshme ZAP-së	540,000	960,000	-
Totali	697,315	960,000	400,000

Projekti i Binjakëzimit paraqet një rast për përmirësim të kapacitetit të ZAP-së duke vë në zbatim mjetet në platformën tonë si dhe përmes zhvillimit të mëtutjeshëm të tyre.

Projekti i binjakëzimit është një bashkëpunim mes nesh dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Britanisë së Madhe (si partneri kryesor) dhe Gjykatës Sillovene të Auditimit (si partner junior)

Ekspertët nga Britania e Madhe, Holanda, dhe Sllovenia janë duke bashkëpunuar ngushtë me ne në zbatimin e standardeve të njohura ndërkombëtarisht të auditimit dhe praktikat e mira evropiane.

Projekti i ZNKE-së ka financuar, ndër të tjera, këshilltarë dhe administratorë me orar të plotë, të cilët kanë qenë të përfshirë më shumë në aktivitetet operative se sa në ato zhvillimore. Numri i këtyre burimeve që punojnë në zyrën tonë ka qenë tetë në vitin 2007, shtatë në vitin 2008, dhe tre në vitin 2009.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh se stafi i financuar më parë nga partnerët tanë janë konsideruar si ekspertë, të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë luajtur një rol kryesor si në menaxhimin e zyrës ashtu edhe në produktet tona në mënyra të ndryshme.

4.2 Burimet njerëzore

Aftësitë dhe përvoja e stafit tonë janë pasuria jonë më e madhe. Më poshtë ju do të gjeni informacione të rëndësishme në lidhje me këto burime.

Stafi

Tabela 6 paraqet një numër të pozitave dhe numrin aktual të punonjësve të ndarë në stafin e auditorëve dhe stafin mbështetës për fund vit.

Tabela 6 Kategoritë e stafit (për fund vit)

Kategoria	2009		2008		2007	
	Shifrat aktuale	Pozitat	Shifrat aktuale	Pozitat	Shifrat aktuale	Pozitat
<i>Stafi i auditorëve</i>	64		58		59	
<i>Stafi mbështetës</i>	21		22		22	
Total	85	106⁵	80	90	81	86

Gjatë analizës së informacionit të ofruar në tabelë së bashku me informacionin e mëhershëm, është e qartë se burimet e përgjithshme të vëna në dispozicionin tonë në mënyra të ndryshme dhe me mekanizma të të ndryshme janë zvogëluar me kalimin e viteve.

Rritja e parashikuar e numrit të stafit vendor sipas marrëveshjes mes Kosovës dhe BE-së (PVPE⁶ 2008) u miratua në nivelin prej +20% në vit, duke kompensuar kështu zvogëlimin e stafit ndërkombëtar. Përveç numrit shtesë të pozitave, niveli i miratuar nuk është arritur. Fondet shtesë për pozitat e reja u miratuan gjithashtu në Kuvend në fund të nëntorit, duke më pamundësuar që ti punësoj ata gjatë vitit 2009.

Buxheti për vitin 2010 mbulon 116 pozita, i cili është edhe numri i tanishëm i stafit.

Informacion i shkurtër rreth stafit tonë

Tabelat më poshtë paraqesin informacion themelor rreth stafit në organizatën tonë. Shifrat tregojnë se ne po hasim sfida gjatë ngritjes së kapacitetit dhe ruajtjes së personelit të aftë dhe me përvojë, i cili është i aftë të absorbojë dhe të trajtojë proceset e reformës në të cilën jemi duke kaluar.

⁵ Financimi i 106 pozitave, në vend të 90, u bë i mundshëm nga Kuvendi në fund të nëntorit 2009

⁶ Plani i Veprimit për Partneritet Evropian

Tabela 7 Struktura e moshës

Kategoritë	25 - 40	41 - 55-	56 e më tej
<i>Stafi i auditorëve</i>	41	21	2
<i>Stafi mbështetës</i>	13	8	

Tabela pasqyron strukturën e moshës së stafit të zyrës tonë, ku 2/3 e stafit të auditorëve janë nën moshën 40 vjeçare. Kjo përqindje rritet me rekrutimin e stafit të ri.

Tabela 8 Rekrutimi dhe lëvizja e stafit

Kategoritë /Vitet	Rekrutimi i stafit			Lëvizja e stafit		
	2009	2008	2007	2009	2008	2007
<i>Stafi i auditorëve</i>	11	7	3	5	8	5
<i>Stafi mbështetës</i>	7	1	7	6	2	7
Totali	18	8	10	11	10	12

Rekrutimi dhe ruajtja e stafit kanë qenë një problem për ne. Gjatë vitit 2009 janë ndërmarrë hapa të rëndësishme në lidhje me të dyja këto çështje siç tregohet në tabelën 8.

Tabela 9 Gjinia

Gjinia	2009	2008	2007
Femra	24	14	14
Meshkuj	61	66	67

Ashtu siç paraqitet në tabelën 9, në vitin 2009 u ndërmor hapi i parë praktik në sigurimin e barazisë gjinore në zyrën tonë. Duke u bazuar në mënyrë strikte mbi meritën, ne ia dolëm ta përmirësonim këtë situatë, nga 18% e çuam në 28 %. Numri i madh i rekrutimit të bërë në vitin 2010 ka çuar në një gjendje ku numri i femrave në stafin tonë është 38%.

Gjithashtu, është e rëndësishme që të theksohet se gjatë procesit të ristrukturimit të brendshëm, ne kemi filluar edhe promovimin e femrave në pozita të larta. Ofrimi i parakushteve më të mira për këtë, është një sfidë të cilën jemi duke e trajtuar vazhdimisht.

Tabela 10 Komunitet

Komuniteti	2009	2008	2007
Shqiptarë	80	76	77
Serbë	4	3	3
Të tjerë	1	1	1

Tabela 10 paraqet një mangësi gjatë këtij viti. Ne nuk kemi qenë të suksesshëm për të rritur numrin e komuniteteve të tjera në zyrën tonë, pavarësisht masave të marra për këtë. Ne duhet të fokusohemi më shumë në këtë sfidë nëse do të mund të jemi në gjendje për të përmbushur ambicien tonë për mundësi të barabarta.

Një gjë pozitive është që ne mundëm të nënshkruanim një marrëveshje me Shoqatën Serbe të Kontabilistëve dhe Auditorëve, e cila na bën të mundur që të sigurojmë trajnime të mjaftueshme për komunitetin tonë serb i cili ka kaluar në fazën e parë të provimeve gjatë vitit.

Historiku i arsimimit

Historiku i arsimimit të punonjësve tanë është kryesisht nga fusha e ekonomisë. Gjithashtu, ka anëtarë të stafit të cilët kanë ndjekur studimet universitare në fushën e juridikut, shkencave politike, inxhinierisë, etj. Ky grup parashihet të rritet sipas zbatimit të auditimit të performancës. Pjesë e stafit janë gjithashtu punonjës me arsim të mesëm që punojnë në funksionin e mbështetjes. Të gjithë auditorët zotërojnë diplomat e universitetit. Përqindja e stafit akademik është rritur nga 83% deri në 86% gjatë tre viteve të fundit.

Zhvillimi Profesional

Trajnimi është një aspekt i rëndësishëm i institucionit tonë. Prandaj, një shumë e konsiderueshme e buxhetit dhe kohës tonë është investuar në trajnimet profesionale për stafin e auditimit të rregullsisë sipas një skeme të veçantë certifikimi. Aktualisht, ofruesi i kësaj skeme certifikimi është Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK), dhe skema përfshin tre hapa:

- Teknik i Kontabilitetit;
- Kontabilist i Certifikuar; dhe
- Auditor i Certifikuar.

Numri i auditorëve që i kalojnë fazat e ndryshme të certifikimit po rritet ngadalë por në vazhdimësi, pavarësisht faktit se një numër i stafit të certifikuar janë larguar nga këtu për tu punësuar në pozita të tjera. Në fund të vitit që kaloi, 61 persona nga stafi ynë zotërojnë një lloj certifikimi në SHKÇAK, mbi 90% të auditorëve. Ky proporcion tashmë është zvogëluar me ardhjen e 30 anëtarë të rinj të stafit në organizatë.

Ditët zyrtare të trajnimit përfshijnë trajnime, seminare, dhe punëtori të SHKÇAK të organizuara dhe aranzhuar zyrtarisht nga partnerë të ndryshëm. Trajnimet janë zhvilluar gjatë tre viteve më të fundit si më poshtë:

- 2007: 376 ditë;
- 2008: 800 ditë; dhe
- 2009: 454 ditë.

Gjatë vitit 2009 numri i trajnimeve zyrtare ka qenë shumë i ulët sesa një vit më parë. Arsyeja për këtë ishte fokusimi në punën operative e kombinuar me trajnime në vendin e punës (që nuk përfshihen më lart), në bashkëpunim të ngushtë dhe këshilltarët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Një numër i madh trajnimesh është caktuar gjithashtu për zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Një program i trajnimit të brendshëm është organizuar për të gjithë auditorët tanë. Kryesisht, si trajnues është përdorur stafi i brendshëm por edhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë nga fusha të ndryshme të ekspertizës. Projekti aktual i binjakëzimit gjithashtu mbulon disa aktivitete të trajnimit dhe trajnime në vendin e punës si për stafin e auditorëve ashtu edhe për stafin mbështetës. Gjatë vitit, hapat e para u ndërmorën në zhvillimin e një programi të ri certifikimit për të gjithë auditorët tanë.

5. DUKJA NGA JASHTË E ORGANIZATËS TONË

Mes vlerave kryesore që ne po mundohemi të arrijmë janë krijimi i një reputacioni të mirë të jashtëm, sigurimi i besueshmërisë, dhe ruajtja e integritetit tonë.

Përforcimi i këtyre vlerave duhet të çojë në rezultatet e auditimit në format e ndryshimit. Faktikisht, auditimi i jashtëm duhet të jetë një faktor i ndryshimit. Auditimi më i mirë, mbikëqyrja, dhe mirëkuptimi mes të gjitha palëve të interesuara në shpenzimin me efikasitet të parave të taksapaguesve duhet të rezultojë në një transparencë dhe llogaridhënie më të mirë.

Auditimi ynë duhet të ofrojë një vlerësim të pavarur dhe të bazuar në fakte të cilësisë së informacionit dhe performancës së ekzekutivit. Faktet duhet të jenë gjithmonë baza për vendimet e reja.

Me këtë synim, ne jemi duke e ndërtuar zyrën tonë që të bëhet një organizatë e mbështetur në njohuri, që jep një shkëlqim profesional, e pavarur dhe kumtuese në një mënyrë objektive dhe të balancuar, ashtu siç janë edhe objektivat tona kryesore strategjike. Deri tani, ne kemi bërë mjaft përpjekje për të rifituar besimin e publikut në punën tonë, e cila në të kaluarën kishte rënë paksa.

Përveç rezultateve tona aktuale si nga perspektiva vendore ashtu edhe ndërkombëtare, ende mbetet shumë punë për të bërë me qëllim që të arrijmë nivelin të cilin jemi zotuar të arrijmë.

Bashkëpunimi kombëtar

Kur është fjala për bashkëpunimin tonë me Kuvendin, hisedari ynë kryesor gjatë vitit 2009 ishte Komisioni për Buxhet dhe Financa. Në fund të vitit, u themelua Komisioni i ri për Mbikëqyrje të Financave Publike. Komisioni i cili nën domenin e tij do të ketë të gjitha çështjet e ZAP-së.

Në krijimin dhe prezantimin e këtij Komisioni të fundit ne kemi marrë pjesë në një numër diskutimesh për të zhvilluar marrëdhënie efektive pune bazuar në kuptim të përbashkët për rolet dhe objektivat e njëri-tjetrit.

Për më tepër, ne kemi krijuar një bashkëpunim të mirë pune me MEF-in dhe entitetet tjera të audituara në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të sistemeve dhe proceseve të menaxhimit të financave publike, si dhe aranzhimet e besueshme të raportimit.

Ne kemi krijuar komunikimet e rregullta me Njësinë Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (NJQH / AB) dhe kemi marrë pjesë në mbledhjen vjetore të drejtorëve të auditimit të brendshëm me qëllim të zhvillimit të auditimit të sektorit publik në Kosovë. Për më tepër, ne bashkëpunojmë mbi baza të vazhdueshme duke koordinuar aktivitetet tona reciproke në mënyrë që të bëhemi më efektiv si dhe për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve të njëjta.

Ne kemi krijuar një raport bashkëpunimi me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Kontrollin e Menaxhimit të Financave (NJQH / KMF) me qëllim të optimizimit të zhvillimit dhe implementimit të kontrolleve të menaxhimit financiar në Qeverinë e Kosovës.

Përveç kësaj, gjatë gjithë vitit kemi pasur një bashkëpunim të mirë me Shoqatën Profesionale të Auditimit, OJQ-të, firmat private të auditimit, ofruesit kombëtar të trajnimit, mediat, donatorët, dhe gjyqësorin me qëllim të nxitjes së praktikave të mira të menaxhimit financiar, zhvillimin e profesionit tonë, forcimin e transparencës dhe llogaridhënies.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Faza e finalizimit të bashkëpunimit tonë me Tribal Helm në kuadër të projektit të mbështetur të BE-së “Krijimi dhe Themelimi i një ISA në Kosovë” duhet të vështrohet si një gjë mjaft e suksesshme. Së bashku, ne ishim në gjendje të ndërtojmë platformën e re të ZAP-së dhe të fillojmë me disa aktivitete vizibile duke hapur rrugën për progres të bërë më vonë gjatë vitit.

Në lidhje me projektin e binjakëzimit për forcimin e ZAP-së, projekt ky i financuar nga BE-ja, ne kemi zhvilluar një bashkëpunim të mrekullueshëm me partnerët tanë nga Zyrat Kombëtare të Auditimit të, Britanisë së Madhe, Sllovenisë dhe Holandës. Për më tepër, ne kemi qenë në një vizitë katër ditore në Gjykatën Sllovene të Auditimit në Ljubljana si dhe Auditori i Përgjithshëm i Sllovenisë ka vizituar zyrën tonë, ku ka qëndruar për një javë. Kur bëhet fjalë për partnerët nga Britania e Madhe dhe Holanda, ne gjithashtu kemi vlerësuar lartë bashkëpunimin e mirë që e kemi pasur me ta dhe ne do ti vizitojmë Zyrën e tyre gjatë rrjedhës së projektit.

Për sa i përket Komunitetit Ndërkombëtar, ne kemi bërë përpjekje të mëdha që ti bashkohemi rrjeteve profesionale ndërkombëtare. Për shkak se Kosova nuk është anëtare e KB-së, ne nuk mund të jemi anëtarë të INTOSAI dhe EUROSAI. Por, ne jemi duke bërë përpjekje që si hap të parë të marrim statusin e vëzhguesit dhe me rastin e dhënë të marrim pjesë në seminare dhe punëtori duke ndarë përvojën me kolegët nga vendet tjera.

Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin regjional, ne kemi marrë pjesë në konferencën e EURORAI-it në Barcelonë ku janë mbledhur Institucionet Regjionale të Auditimit.

Ne kemi krijuar marrëdhënie të mira pune me Qendrën për Ekselencë Financiare (CEF) në Slloveni si qendër rajonale për ndihmë në zhvillimin e menaxhimit të financave publike në vendet në tranzicion. Bashkëpunimi ynë është i fokusuar në zhvillimin e materialit trajnues si dhe në ofrimin e trajnimeve formale për Auditorët e Brendshëm dhe ata të Jashtëm në Kosovë.



Ngjarja e Vizibilitetit, Korrik 2009: Ken M Dye (ish- AP, Kanada), Lage Olofsson, Sean Sweeney (Kryeshef Ekzekutiv, Tribal Helm) dhe Mauritz de Braw (ish Sekretari i Përgjithshëm, Gjykata e Auditorëve, Holandë)

6. TË ARRITURAT STRATEGJIKE

Kjo është një përmbledhje e rezultateve të arritura në raport me drejtimin tonë strategjik afat gjatë për të qenë një ISA me performancë të mirë siç paraqitet edhe në Planin Strategjik për Zhvillim të Përbashkët për periudhën deri në fund të zbatimit të Planit Gjithëpërfshirës për Kosovën. Ne kemi ndërtuar platformën e parë në qasjen tonë “hap pas hapi” për themelimin e Zyrës kombëtare të Auditimit të Kosovës që e kryen mandatin e saj në mënyrë të qëndrueshme dhe në pajtim me standardet e auditimit ndërkombëtarisht të njohura dhe praktikrat e mira Evropiane, e menaxhuar plotësisht nga Kosovarët.

Ky është RVP i dytë që jemi duke e prodhuar me kohë, dhe mbulon vitin fiskal 2009. Gjatë këtij viti, ne kemi filluar me reforma organizative dhe funksionale të ZAP-së që tashmë ka nxitur më tepër profesionalizëm, mbulim më të mirë të auditimit dhe dhënien e cilësisë më të lartë në operacionet e auditimit.

Si ndikim të drejtpërdrejt të konceptit tonë të ri, ne kemi përmirësuar afatet kohore, lexueshmërinë, dhe relevancën e raportimit tonë. Për herë të parë, ne kemi dorëzuar RVP-në tonë të vitit 2008, Kuvendit brenda afatit ligjor me cilësi më të mirë se më herët, prezantuar dhe diskutuar me Komisionet Parlamentare.

Ne kemi nxjerrë mjete të reja operative (Korniza e Cilësisë, Struktura Organizative, Manuali i Auditimit të Rregullsisë, Udhëzuesit e Auditimit, Kodi i Mirësjelljes) duke vendosur kështu platformën themelore për të arritur objektivat tona strategjike.

Platforma jonë e re hapi rrugën për prezantimin e një qasje të re të auditimit të njohur si " Auditim i parakohshëm" duke filluar auditimet tona para përfundimit të vitit. Në këtë mënyrë, ne jemi më parandalues dhe të dobishëm për entitetet e audituara, *duke i dhënë këshilla para finalizimit të pasqyrave financiare.*

Në pajtim me rrethanat, kemi rritur mbulimin tonë të auditimit duke kryer 46 auditime më shumë në krahasim me sezonin e kaluar të auditimit (72 auditime në krahasim me 26 auditimet e sezonit të kaluar).

Një tjetër risi është se ne kemi filluar me mbulimin e Ndërmarrjeve Publike duke kryer tre auditime shtesë (një në Kompaninë Rajonale të Ujësjetës “Prishtina”, një në Kompaninë Rajonale për Mbeturina “Pastrimi”, dhe një në Ngrohjen Qendrore “Termokos”) përveç Fondit të Privatizimit dhe RTK-së.

Si pjesë e projektit të binjakëzimit të BE-së, ne kemi shfrytëzuar gjashtë pilot auditime (katër të Rregullsisë dhe dy të Performancës) të mentoruara nga Këshilltarët britanikë dhe holandez për mbylljen e veprimeve tona në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktika të mira Evropiane.

Përmes ofrimit të trajnimeve formale, ne ishim angazhuar në mënyrë aktive në ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve publik financiar duke lehtësuar procesin e delegimit të shpenzimeve nga niveli qendror i Thesarit tek Organizatat buxhetore.

Sa i përket çështjeve tona të brendshme, brenda zyrës tonë ne kemi promovuar praktika më të zhvilluara të punës, përgjegjshmëri menaxheriale bazuar mbi performancën dhe të praktikës së mirë të qeverisjes për të përmirësuar kapacitetet administrative dhe ato të menaxhimit.

Në fund të vitit (2009), kemi filluar me procedurat e punësimit për rreth 30 anëtarë të rinj të stafit, në këtë mënyrë ne do të jemi në gjendje të mbulojmë një pjesë të arsyeshme detyrimeve që dalin nga mandati ynë.

Duke bërë këtë, ne kemi dhënë një kontribut të konsiderueshëm në procesin e vazhdueshëm të

zhvillimit të një sistemi të shëndoshë të menaxhimit financiar të Qeverisë në koordinim me partnerët dhe hisedarët tanë.

Ne kemi krijuar një ambient pune ku nxitet fryma e bashkëpunimit dhe kënaqësia e punonjësve është duke u ngritur në mënyrë të konsiderueshme.

Megjithatë, pavarësisht nga këto arritje, ne gjithashtu kemi identifikuar *mundësitë për përmirësim*.

Para së gjithash, nuk ka kuptim të mjaftueshëm nga publiku dhe pranim të rolit, pozitës, misionit, dhe kompetencave tona, sipas standardeve të INTOSAI dhe praktikave të mira të BE-së. Ne kemi hasur një zbrazëtim mes asaj që ne ofrojmë në përputhje me këto standarde dhe pritjet e jashtme të vënë mbi ne.

Ne gjithashtu kemi hasur në disa sfida, kur është fjala për kontrollin e ndërmarrjeve publike që vijnë nga degët e ekzekutivit në raport me zgjerimin e fushëveprimit tonë të auditimit ndaj Ndërmarrjeve Publike (NP-të). Ne gjithashtu kemi vënë re nevojën për ndryshim të kornizës ekzistuese ligjore për NP-të, kur është fjala për auditim të jashtëm.

Sfida më e madhe e mbetur si e pazgjidhur është çështja e hapësirës për punë: një kërcënim i madh për objektivat tona strategjike pavarësisht dialogëve të shumta, premtimeve, marrëveshjeve me aktorët tanë të jashtëm. Objekti aktual nuk përmbush nevojat tona të tanishme dhe të evoluara (Prill 2010). Nuk paraqet as vlerën për para. Prandaj, ne e konsiderojmë atë si prioritet numër një me të cilin duhet të merremi me urgjencë.

Dhe së fundi, në raportin e fundit të *“Transparency International”* për vitin 2009, ne u vlerësuam si organizata me performancë më të mirë dhe më e besueshme në sektorin publik (së bashku me Ombudspersonin).

Në krijimin e këtyre arritjeve strategjike një hap shumë i rëndësishëm ka qenë *zhvillimi i një makinerie të brendshme të zyrës*. Qasja e menaxhimit është ndryshuar, dhe ne jemi duke u përpjekur të zhvillojmë një organizatë që karakterizohet nga orientimi tek rezultati dhe të mësuarit nga përvojat e fituara.

Të ndërtohet një kuadër me staf të përgjegjshëm kërkon pjesëmarrje dhe llogaridhënie të brendshme: të jepen parakushte për stafin që të zhvillohet me kalimin e kohës.

Gjatë vitit, janë marrë një sërë masash për ta lehtësuar këtë. Ne kemi qenë mjaft të suksesshëm në këtë, përveç tjerash kjo tregohet nga interesi dhe përkushtimi treguar nga stafi ynë në ballafaqimin e sfidave që kemi.

Organizimi i ri ka paraqitur fokusimet në përgjegjësitë që mbulojnë fushat e politikave. Janë prezantuar një numër i funksioneve për lehtësimin e kualitetit dhe njohurive të ekspertëve në fushat me rëndësi për menaxhimin e përgjithshëm e Shpenzimeve Publike. Përshkrimet e reja të punës janë hartuar duke e bërë të qartë gjithëve për pritjet dhe duke i dhënë një bazë të mirë për vlerësime dhe zhvillim të mëtutjeshëm individual dhe kolektiv. Hapi tjetër do të jetë prezantimi i kohës së raportimit siç duhet duke hapur rrugën për një efikasitet të brendshëm më të lartë. Prioriteti i një rëndësie të veçantë është përdorimi në mënyrë të matur i burimeve të dhëna dhe sigurimi që stafi ynë të ketë mjetet e nevojshme.

Një sfidë e vazhdueshme është prezantimi dhe ruajtja e një filozofie menaxhimi ku, në kuptimin praktik, ne mund të shihemi si model.

7. LLOGARIDHËNIA E ZAP-SË

Sigurimi i integritetit

Me këtë unë ju siguroj, se informacionet në Raportin Vjetor të Performancës, përfshirë këtu Pasqyrat Financiare, janë të sakta, të besueshme dhe objektive.

Lars Lage Olofsson, Auditori i Përgjithshëm



Deklarata për Transparencë

Me këtë ne ju sigurojmë se veprimtaria jonë gjatë vitit 2009 është zhvilluar në përputhje me Statutin e Shërbimit Publik dhe Kodin e Mirësjelljes së ZAP-së.



Qerkin Morina, Zëvendës Auditor i Përgjithshëm;



Ibrahim Gjylderren, Zëvendës Auditor i Përgjithshëm;



Fatmir Uka, Drejtor i Administratës.

Opinionimi Auditimit të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave të bashkëngjitura Financiare për 2009 në këtë RVP nuk është finalizuar. Posa të përfundoj kjo ne do të publikojmë raportin e auditorëve të jashtëm në faqen tonë të internetit.

Nga pikëpamja jonë, është praktikë e mirë që kryesuesi, Kuvendi, emëron auditorët tanë. Ne veçse kemi propozuar në RVP-në e vitit 2008, se Kuvendi duhet ti emëroj auditorët, për auditimin e PVF-ve tona, para shtatorit të vitit 2009.

Kjo çështje është diskutuar me Kuvendin gjatë vitit të kaluar, me qëllim që raporti i Auditorëve të jashtëm, të jetë i finalizuar me kohë, që ne ti prezantojmë Pasqyrat e audituara Financiare në RVP-në e këtij viti. Vendimi ende duhet të merret nga Kuvendi lidhur me këtë.

Annex

Pasqyrat Financiare Vjetore të ZAP-it për vitin 2009

Pasqyrat financiare te ZAP për vitin 2009

Neni 9. Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave të Parave të Gatshme

		2009	2008	2007	
		Llogaria e Vetme e Thesarit BKK	Llogaria e Vetme e Thesarit	Llogaria e Vetme e Thesarit	
Shënimet		€ '000	€ '000	€ '000	
PRANIMET					
	Ndarjet nga Fondi i Përgjithshëm	2	1,290	1,204	1,227
Totali i Pranimeve		1,290	1,204	1,227	
PAGESAT					
Operacionet					
	Pagat dhe Mëditjet	5	585	406	336
	Mallrat dhe Shërbimet	6	535	429	463
	Shërbimet Publike	7	26	28	23
		1,146	863	821	
	Prona, Ndërtesa dhe Pajisjet	9			32
Totali i Pagesave		1,146	863	853	

Neni10. Raporti i ekzekutimit të buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2009

	<u>2009</u>				<u>2008</u>	<u>2007</u>
	Buxheti fillestar (Ndarja) A	Buxheti Final (Ndarja) B	Aktuali C	Varianca D=C-B	Pagesat E	Pagesat F
<u>Shënime</u>	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrja e parasë se gatshme ne llogari te thesarit						
Pranimet totale te mbledhura për BKK-ne	-	-	-	-	-	-
Daljet e parasë se gatshme nga llogarite e thesarit		-				
Pagat dhe mëditjet	17	523	585	(81)	406	336
Mallrat dhe Shërbimet	18	551	535	(56)	429	463
Shërbimet publike	19	33	26	(7)	28	23
Shpenzimet kapitale	21			-		32
Totali i pagesave bere nga BKK nëpërmes te LIVTh	1,107	1,290	1,146	(144)	863	853

1.Në muajin maj të vitit 2009, gjate procesit të rishikimit të buxhetit kemi kërkuar rritjen e stafit për 16 pozita të reja me një buxhet shtesë në paga dhe mëditje në vlerë prej 33,541€ .Kjo kërkesë e ZAP-it është aprovua nga Kuvendi me datën 19.11.2009,ndërsa mjetet janë alokue me 26.11.2009. Vonesa në aprovimin e kërkesës , ZAP-it i ka pamundësua regrutimin 16 pozitave të reja gjegjësisht mos shpenzimin e mjeteve në paga dhe mëditje.

² . Në kategorinë për mallra dhe shërbime (shërbimet intelektuale këshillëdhënëse) janë pagesat për kontraktim te kompanive te jashtme audituse .Duhet përmend faktin se për këtë destinim janë ndarë mjete nga rezerva e Ministrsit në vlerë prej 40,000€, po ashtu të kërkuara me proces të rishikimit ,dhe të njëjtat janë alokue me 26.11.2009. Alokimi me vonesë i këtyre mjeteve ka shkaktua që nga vlera në fjalë të shpenzohen vetëm 8,880€ dhe te mbesin pa u shpenzua 31.120€.

Neni 11. Shpalosja e shënimeve

Shënimi 2. Ndarjet e fondit të përgjithshëm

	2009 BKK € '000	2008 € '000	2007 € '000
Klasifikimi ekonomik			
Pagat dhe mëditjet	666	523	347
Mallrat dhe Shërbimet	591	649	812
Shërbimet Publike	32	33	28
Shpenzimet Kapitale			40
	1,290	1,204	1,227

Shënimi 5. Pagat dhe mëditjet

	2009 BKK € '000	2008 € '000	2007 € '000
Përshkrimi			
Pagesat nga BBK			
Neto pagat	498	347	290
Tatimi mbi te hyrat personale	31	20	14
Pagesa e kontributit pensional nga pune dhënësi	28	19	16
Pagesa e kontributit pensional nga I punësuari	28	19	16
Totali	585	406	336

Shënimi 6. Mallrat dhe shërbimet**Përshkrimi****Pagesat nga BKK**

Shpenzimet e udhëtimit

Internet

Shpenzimet tjera telefonike vala900

Shërbimet e arsimit dhe trajnimit

Shërb e ndr. intelektuale këshill dhënëse

Shërbime kontrakt tjera

Shërbime teknike

Mobilet dhe pajisjet(me pak se 1000)

Telefona (me pak se 1000€)

Kompjuterë (me pak se 1000€)

harduer për TI<1000

makina fotokopjuese<1000

Pajisje tjera <1000€

Pajisje tjera (1000-5000)

Furnizime për zyre

Furnizime ushqim dhe pije

Furnizime pastrimi

Furnizime veshmbathje

Akomodimi

Vaj për ngrohje

Derivate për gjenerator

Karburant për vetura

Regjistrimi dhe sigurimi I automjeteve

Sigurimi i ndërtesave dhe tjera

Mirëmbajtja dhe riparimi I automjeteve

Mirëmbajtja e ndërtesave

Mirëmbajtja e tekn. informative

Qiraja për ndërtesa

Reklamat dhe konkurset

Botimet e publikimeve

Informimi publik

Drekat zyrtare

Totali

	2009 € '000	2008 € '000	2007 € '000
Shpenzimet e udhëtimit	16	34	13
Internet	1	0	1
Shpenzimet tjera telefonike vala900	18	17	16
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	16	15	31
Shërb e ndr. intelektuale këshill dhënëse	118	54	69
Shërbime kontrakt tjera	17	8	1
Shërbime teknike	1	2	2
Mobilet dhe pajisjet(me pak se 1000)	22		4
Telefona (me pak se 1000€)	1	1	0
Kompjuterë (me pak se 1000€)	18		29
harduer për TI<1000	2		
makina fotokopjuese<1000	5		
Pajisje tjera <1000€	17	28	15
Pajisje tjera (1000-5000)		11	
Furnizime për zyre	21	4	21
Furnizime ushqim dhe pije	2	0	2
Furnizime pastrimi	4	6	1
Furnizime veshmbathje	10	2	4
Akomodimi		0	1
Vaj për ngrohje	2	4	3
Derivate për gjenerator	1	7	6
Karburant për vetura	8	9	12
Regjistrimi dhe sigurimi I automjeteve	7	9	5
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	14	15	18
Mirëmbajtja dhe riparimi I automjeteve	6	5	7
Mirëmbajtja e ndërtesave	10	7	7
Mirëmbajtja e tekn. informative	9	0	4
Qiraja për ndërtesa	168	168	168
Reklamat dhe konkurset	0	9	10
Botimet e publikimeve	10	8	12
Informimi publik	10		
Drekat zyrtare	2	4	2
Totali	534	429	463

Shënimi 7. Shërbimet komunale

	2009	2008	2007
	BKK		
<u>Përshkrimi</u>	€ '000	€ '000	€ '000
Shpenzimet për komunalitet të paguara nga BKK	26	28	23

Shënimi 9. Investimet kapitale

	2009	2008	2007
	BKK		
<u>Përshkrimi</u>	€ '000	€ '000	€ '000
Pajisje teknologjike informatike			32

Shënimi 25. Pasqyra e faturave (obligimeve) të papaguara të organizatës buxhetore

€ '000

<u>Përshkrimi</u>	<u>Furnitori</u>	<u>Arsyeja e mos pagesës</u>	
pastrimi i ndërtesës	"Pastrimi"	skadimi i afatit për zotim	0.32
roaming	"PTK"	skadimi i afatit për zotim	0.27
informim publik	"Gazeta ditore"	skadimi i afatit për zotim	1.16
pastrimi i veturave	"Vali"	skadimi i afatit për zotim	0.07
rryma	KEK/komunali	skadimi i afatit për zotim	1.16
uji/komunali	"Prishtina"	skadimi i afatit për zotim	0.05
telefoni fiks	"PTK"	skadimi i afatit për zotim	1.11
pastrimi i ndërtesës	"Dolfin"	skadimi i afatit për zotim	0.91
sigurimi i ndërtesës	"Bodyguard"	skadimi i afatit për zotim	1.18
naftë për vetura	"Petrol Company"	skadimi i afatit për zotim	1.30
pije	"Dionisi"	skadimi i afatit për zotim	0.08

Totali**7.61**

Shënimi 27. Përmbledhje e pasurive jo-financiare në posedim të organizatës buxhetore

Klasifikimi i pasurive	2009 € '000	2008 € '000	2007 € '000
vetura	193.35	193.35	193.35
pajisje te TI	329.59	287.49	287.49
pajisje tjera	68.82	65.2	61.80
	591.76	546.04	542.64
pajisje tjera me vlerë më të vogël se 1000€			
pajisje te ti	16.36	251.38	218.09
kompjuterë	119.44		
makina fotokopjuese	26.49		
softuer për auditorë	14.93		
mobile	63.46		
Pajisje tjera	29.15		
	269.84	251.38	218.09
Totali	861.60	797.42	760.73

Neni 17. Raporte plotësuese

Shënimi 30. Harmonizimi i ndarjeve fillestare dhe finale te buxhetit

Kategoria e ndarjes	Ndarja Fillestare Buxhetore (ligji i buxhetit) € '000	Ndryshimi sipas nenit 29,Ligji nr. 03/L-048 € '000	Ndarjet finale te buxhetit SIMFK € '000	Ndryshimet e buxhetit fillestar € '000
Hyrjet				
Daljet(buxheti)				
Pagat dhe mëditjet	523	143	666	21.4%
Mallrat dhe shërbimet	551	40	591	6.8%
Shërbimet publike	33		33	0.0%
Totali	1,107	183	1,290	16.5%

Në kategorinë për paga dhe mëditje gjate vitit kane ndodhur këto ndryshime:

1	34,154	është rritur masa monetare për shkak te ngritjes se koeficientit nga 32.5 ne 35.8 janë ndarë me rishikim të buxhetit
2	54,847	këtu kemi rritje për 17,000 për rritje te pagave për stafin mbështetës (administratën),3000 për pagesën e shtesave te udhëheqësve te ekipeve te auditit (Transfer nga rezerva e Ministrit)
3	20,000	
4	33,541	pagesa për paga për shkak te rritjes se stafit për 16 pozita te reja(Transfer nga Rezerva e Ministrit)
Në kategorinë për mallra dhe shërbime kemi ndryshim për:		
5	40,000	për auditimin e komunave (Transfer nga rezerva e Ministrit)

Raport i ekzekutimit të Buxhetit

		Buxheti fillestar	Buxheti Përfundimtar	Pagesat	Progresi	Progresi
Përshkrimi	shënimet	Ligji nr. 03/L-105	SIMFK		në, %	në, %
a		b	c	d	e=d/b	f=d/c
Pagesat nga Grandi i Përgjithshëm	TOTALI	1,107	1,290	1,146	103.5%	88.9%
Rrogat dhe Pagat		523	666	585	111.8%	87.9%
Mallrat dhe Shërbimet		551	591	535	97.1%	90.5%
Shpenzimet Komunale		33	33	26	79.5%	79.5%

Raport i Pagesave sipas Programeve

Përshkrimi	shënimet	Programi 1 Departamenti i Auditorëve	Programi 2 Departamenti i Tekn. Informative.	Programi 3 Departamenti i Administratës	Gjithsej Pagesat
a		b	c	d	f=b+c+d+e+
Pagesat nga Grandi i Përgjithshëm	TOTALI	451	30	664	1,146
Rrogat dhe Pagat		451	30	104	585
Mallrat dhe Shërbimet				535	535
Shpenzimet Komunale				26	26

Klasifikimi Ekonomik

Pagesat nga Grandi i Përgj	shënimet	Rrogat dhe Mëdi.	Mallrat dhe Shërbim	Shpenzimet Komun	Totali
	Shërb e Përgj. Publike	585	535	26	1,146
	TOTALI	585	535	26	1,146

Neni 12. Numri i punëtorëve

Departamenti	Nr i punëtorëve ne Ligjin e buxhetit 03/L-105	Nr. Aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2009 me orar të plotë	Nr. Aktual i punëtorëve në fund të vitit 2009 me orar të plotë
TOTALI	90	90	86
Departamenti i Auditorëve	63	63	61
Departamenti i Administratës	23	23	21
Departamenti i Tekno. informative	4	4	4